

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët: Gani Zabeli kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Besnike Miftari, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër M.Gj. nga Prizreni, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.403/2015 i datës 01.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 23.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së të akuzuarit M.Gj. e sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.403/2015 i datës 01.03.2018, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit përkitazi me veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPK-së, për të cilën është shpallur fajtor, e refuzon akuzën në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 107 par. 8 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.403/2015 të datës 01.03.2018, të akuzuarin M.Gj. e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPK dhe e ka gjykuar me dënim me kusht, ashtu që të njëjtit i është vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. E dëmtuara F.P. nga Prizreni, rr. "...” nr.110, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i akuzuari për shkak të shkajës së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të mbrojtjes jo ligjore të paraqitësit të rrejtshëm, mbrojtjes jo ligjore të parashtruesit të aktakuzës dhe parashkrimit të aktakuzës me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovojë ankesën dhe të hudhë aktgjykimin e ankimuar për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.823/18 datës 16.08.2018, ka propozuar që Gjykata e Apelit ankesën etë akuzuarit ta shpallë jo lëndore ndërsa sipas detyrës zyrtare të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të refuzojë aktakuzën, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, gjeti se:

- Me aprovimin e e ankesës së të akuzuarit M.Gj. e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet ndryshuar sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, përkritazi lidhur me vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del se i akuzuari M.Gj. është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK dhe është gjykuar me dënim me kusht, ashtu që të njëjtit i është vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale

I akuzuari M.Gj. është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK për të cilën parashihet dënimi me gjobë apo me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj. Sipas dispozitës së nenit 106 par. 1 pika 1.6 të KPRK-së, për vepër penale të dënueshme deri në 1 (një) vit burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 (dy) vite nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se vepra penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK është kryer me datë 29.05.2014, kurse afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret, lënda me ankesë është dorëzuar në Gjykatën e Apelit me datë 31.07.2018 dhe me datë 01.08.2018 nga Prokurori i Apelit është kërkuar mendimi lidhur me ankesën e parashtruar. Prokurori i Apelit, i ka kthyer shkresat e lëndës në këtë Gjykatë me datë 17.08.2018 ndërsa gjyqtarës së çështjes, lënda i është dorëzuar me 23.08.2018. Duke pasur parasysh se prej kohës së kryerjes së veprës penale (29.05.2014) e deri në dorëzimin e lëndës ke gjyqtarja e çështjes me datën 23.08.2018, kanë kaluar më tepër se 4 (katër) vite, aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 454 par. 1 të KPPK-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.817/18, datë 23.08.2018

Bashkëpunëtorja profesionale,
Besnike Miftari

Kryetari i kolegjit- gjyqtari,
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi
Afrim Shala